



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE E JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM KORÇË  
ZYRA E SHERBIMIT POGRADEC

Nr. Akti 00268-22Regj

Datë 15.06.2023

SHPALLJE VENDIMI

Pranë: Bashkia Maliq.

Për shtetasin: Enkeleda Bujar Goxhenji, me adrese ne Fshatin Vreshtas Maliq.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Luljeta Kolonja, në gjykatë asistuar nga sekretare gjyqësore Adela Gjorgo, sot më datë 16.06.2022, dha vendim te per ceshtjen me *nr. Vendimi 635-23 dt.16.06.2022* me palë dhe objekt:

**PADITESE:** Enkeleda Goxhenji, e bija e Bujarit dhe e Lavdies, e datelindjes 31.07.1993, lindur ne Pogradec dhe banuese ne Memelisht Pogradec aktualisht ne Vreshtas Maliq.

**I PADITUR:** Gurali Goxhenji, i biri i Hodos dhe i Nailes, i datelindjes 06.11.1958, lindur ne Gurshqipe Korçe dhe banues ne Memelisht Pogradec.

**OBJEKTI :** Vertetimin e urdhrit te menjehershem te mbrojtjes.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr.9669, date 18.12.2006 “Per masa ndaj dhunes ne marredheniet familjare”.

**PJESEMARRESE NE GJYKIM:** Drejtoria e Sherbimit Social te Bashkise Pogradec, ne mungese.

Ne perfundim te hetimit gjyqësor te çeshtjes ne konkluzionet perfundimtare **paditesja** kerkoi leshimin e urdhrit te mbrojtjes per veten e saj dhe per femijen Darjo Goxhenji.

**I padituri** nuk ishte dakord per leshimin e urdhrit te mbrojtjes per paditesen dhe per femijen Darjo Goxhenji.

Drejtoria e Sherbimit Social te Bashkise Pogradec ishte ne mungese.

Mr. 82 Prot - S. Sherb. Social  
dt. 07.07.2023 - STIMP  
dt 06.07.2023

Gjykata pasi analizoi çeshtjen ne teresi dhe shqyrtoi provat e marra ne hetim gjyqesor ,

## VENDOSI

1.Leshimin e urdhrit te mbrojtjes te paditeses Enkeleda Goxhenji dhe femijes Darjo Goxhenji, duke percaktuar keto masa mbrojtese:

a)Urdherohet menjehere i padituri Gurali Goxhenji, qe te mos kryeje veper te dhunes ne familje ndaj paditeses Enkeleda Goxhenji dhe femijes Darjo Goxhenji.

b)Urdherohet menjehere i padituri Gurali Goxhenji, qe te mos kercenoje se do te kryeje veper te dhunes ne familje ndaj paditeses Enkeleda Goxhenji dhe femijes Darjo Goxhenji.

c)Urdherohet menjehere i padituri Gurali Goxhenji, qe te mos cenoje, ngacmoje, kontaktoje apo te komunikojte drejtperdrejt ose terthorazi me paditesen Enkeleda Goxhenji dhe femijen Darjo Goxhenji.

ç)Ndalohet menjehere i padituri Gurali Goxhenji, qe t'i afrohet pertej nje distance prej 100 metra paditeses Enkeleda Goxhenji dhe femijes Darjo Goxhenji.

d)Ndalohet menjehere i padituri Gurali Goxhenji, qe t'i afrohet baneses ku po jeton paditesja Enkeleda Goxhenji dhe femija Darjo Goxhenji, e ndodhur ne Vreshtas, Maliq, banesa e shtetasit Koli Vako, si dhe çdo banese tjeter ku mund te jetoje paditesja Enkeleda Goxhenji dhe femija Darjo Goxhenji.

dh)Ndalohet menjehere i padituri Gurali Goxhenji, te hyje dhe qendroje ne banesen ku po jeton paditesja Enkeleda Goxhenji dhe femija Darjo Goxhenji e ndodhur ne Vreshtas, Maliq, banesa e shtetasit Koli Vako, si dhe çdo banese tjeter ku mund te jetoje paditesja Enkeleda Goxhenji dhe femija Darjo Goxhenji.

2.Kohezgjatja e zbatimit te masave te caktuara sa me siper eshte 1 (nje) vit, duke filluar nga data e leshimit te ketij urdhri mbrojtje.

3.Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen te paditurit.

4.Leshimin e urdhrit te ekzekutimit per titullin ekzekutiv, vendimin date 16.06.2022 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Pogradec, duke u ngarkuar Komisarjati i Policise Pogradec, Sherbimi Permbarimor Gjyqesor, Drejtorja e Sherbimit Social te Bashkise Pogradec, Komisarjati i Policise Maliq dhe Drejtorja e Sherbimit Social te Bashkise Maliq, per ekzekutimin e ketij titulli ekzekutiv.

5.T'i dergohet nga nje kopje e ketij vendimi brenda 24 oreve nga dhenia e tij Drejtorise se Sherbimit Social te Bashkise Pogradec, Drejtorise se Sherbimit Social te Bashkise Maliq, ku kane banimin paditesja dhe i padituri, Komisarjati te Policise Pogradec, Komisarjati te Policise Maliq, si dhe Zyres se Permbarimit Pogradec.

6.Njoftohen palet se shkelja e vendimit te gjykates per leshimin e urdhrin te mbrojtjes perben veper penale ne kuptim te nenit 321 te Kodit Penal.

7.Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçe, brenda 5 diteve duke filluar ky afat, nga e nesërmyja e njoftimit te vendimit te arsyetuar paditeses Enkeleda Goxhenji dhe te paditurit Gurali Goxhenji.

U shpall ne Pogradec sot me date 16.06.2022, ora 14.13.

**SEKRETARE**

**ADELA GJORGO**

**GJYQTARE**

**LULJETA KOLONJA**

*Shënim: Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit.*

*Shpallja do t'iu dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykatë, menjëherë pas afishimit.*

Shpallja u publikua sot në datë \_\_\_\_\_

Per Bashkinë \_\_\_\_\_